



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 208

Tiranë – E premte, 27 nëntor 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 915, datë 4.11.2020	Për përcaktimin e rregullave për njoftimin e detyrimit për vetëdeklarim të adresës nga shtetasit shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të procedurës së plotësimit e të dorëzimit të formularit të vetëdeklarimit dhe të dokumenteve shoqëruese të tij, administrimin e tyre nga autoritetet përgjegjëse, si dhe të shërbimeve të tjera që ofrojnë këto autoritete ndaj shtetasve.....	14717
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 919, datë 25.11.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar.....	14725
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 920, datë 25.11.2020	Për trajtimin me pagë e shtesa mbi pagë dhe për procedurën e kompensimit financiar gjatë qëndrimit në punë të punonjësve të Policisë së Burgjeve.....	14728
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 921, datë 25.11.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 509, datë 1.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për hapjen e procedurës së pranimit në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, për vitin 2020”.....	14734
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 922, datë 25.11.2020	Për disa ndryshime në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 19.5.2010; nr. 230, datë 21.3.2017; nr. 841, datë 24.12.2019; nr. 316, datë 15.5.2019; nr. 125, datë 13.3.2019; nr. 294, datë 21.5.2018; nr. 369, datë 20.6.2018; nr. 65, datë 13.2.2019; nr. 254, datë 24.4.2019; nr. 699, datë 30.10.2019; nr. 737, datë 12.12.2018; nr. 574, datë 28.8.2019; nr. 182, datë 4.4.2019; nr. 15, datë 15.1.2020; nr. 355, datë 29.4.2020; nr. 204, datë 19.2.2009; nr. 450, datë 6.5.2009; nr. 1038, datë 14.10.2009; nr. 125, datë 17.2.2010; nr. 42, datë 21.1.2015; nr. 279, datë 1.4.2015, “Për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi parcelat e objekteve të legalizuara dhe kompensimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken prej tyre”.....	14735

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 923, datë 25.11.2020	Për funksionimin e organizimit e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të mbrojtjes civile.....	14749
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 924, datë 25.11.2020	Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit e të procedurës për pajisjen, ripërtëritjen, refuzimin dhe anulimin e lejes së punës, si punonjës me kualifikim të lartë, të tipit “A/KP”, si dhe të tarifës shtetërore për lëshimin e kësaj lejeje pune.....	14751
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 25.11.2020	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2020 ndërmjet ministrive dhe institucioneve buxhetore.....	14759
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 927, datë 25.11.2020	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2020 ndërmjet institucioneve të sistemit të drejtësisë.....	14760
Udhëzim i ministrit të Kulturës nr. 472, datë 19.11.2020	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 385, datë 13.10.2020, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës në zbatim të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.....	14760



VENDIM
Nr. 915, datë 4.11.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
PËR NJOFTIMIN E DETYRIMIT PËR
VETËDEKLARIM TË ADRESËS NGA
SHTETASIT SHQIPTARË, QË JETOJNË
JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË, TË PROCEDURËS SË
PLOTËSIMIT E TË DORËZIMIT TË
FORMULARIT TË VETËDEKLARIMIT
DHE TË DOKUMENTEVE
SHOQËRUESE TË TIJ,
ADMINISTRIMIN E TYRE NGA
AUTORITETET PËRGJEGJËSE, SI DHE
TË SHËRBIMEVE TË TJERA QË
OFROJNË KËTO AUTORITETE
NDAJ SHTETASVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6, pika 4, e 10, pika 2, të ligjit nr. 14/2016, “Për identifikimin dhe regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e rregullave për njoftimin e detyrimit për vetëdeklarim të adresës nga shtetasit shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të procedurës së plotësimit e të dorëzimit të formularit të vetëdeklarimit dhe dokumenteve shoqëruese të tij, administrimin e tyre nga autoritetet përgjegjëse, si dhe të shërbimeve të tjera që ofrojnë këto autoritete ndaj këtyre shtetasve.

2. Në kuptim të këtij vendimi, “deklarues” konsiderohet çdo shtetas shqiptar me vendbanim të përhershëm jashtë vendit, që aplikon për deklarimin e vendbanimit të tij dhe marrjen e shërbimeve të ofruara.

3. Shtetasit shqiptarë me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë aplikojnë për plotësimin e formularit tip të vetëdeklarimit nëpërmjet shërbimit elektronik në portalin *e-Albania*, sipas procedurës së përcaktuar në manualin që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Forma dhe përmbajtja e formularit tip të vetëdeklarimit të adresës së shtetasve shqiptarë, të cilët jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit të Brendshëm e të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme.

4. Shtetasit shqiptarë mbajnë përgjegjësi administrative për mospërbushje të detyrimit ligjor të vetëdeklarimit të adresës së tyre dhe autoritetet përgjegjëse, në rast konstatimi të mospërbushjes së këtij detyrimi, pezullojnë kryerjen e shërbimit të kërkuar, derisa shtetasi të përmbushë detyrimin ligjor të vetëdeklarimit të adresës.

5. Deklaruesi identifikohet në mënyrë të sigurt në portalin *e-Albania*, duke përdorur numrin personal në pasaportë ose në letërnjoftimin elektronik, të lëshuara nga Republika e Shqipërisë.

6. Deklaruesi plotëson formularin e deklarimit të adresës me të dhënat e adresës së saktë në shtetin ku ka vendbanimin e përhershëm, për veten e tij dhe/ose edhe për anëtarët e së njëjtës certifikatë familjare, në rastin kur ata jetojnë me deklaruesin.

7. Deklaruesi, bashkë me formularin, paraqet çdo dokument zyrtar, i cili provon gjenealogjetet e shtetasit dhe adresën e plotësuar në formular, të njohur nga autoritetet e vendit ku jeton.

8. Të dhënat e formularëve të dërguar verifikohen nga punonjësit e zyrës së gjendjes civile, nëse janë në përputhje me të dhënat e deklaruara në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

9. Autoritetet përgjegjëse i ofrojnë shtetasit shqiptar, në adresën e vetëdekluar e të konfirmuar, këto shërbime:

a) shërbime të gjendjes civile;

b) ushtrim të së drejtës së votës, në zbatim të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

10. Në rast ndryshimi të adresës, shtetasi deklaron adresën e re brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e lidhjes së kontratës së qirasë apo e shitblerjes së objektit të banimit, si dhe çdo dokument tjetër që provon ndryshimin e adresës.

11. Njoftimi i detyrimit ligjor të vetëdeklarimit të adresës së shtetasve shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga autoritetet përgjegjëse bëhet nëpërmjet:

a) publikimit në portalin qeveritar *e-Albania*;



b) publikimit në faqet zyrtare elektronike të Ministrisë së Brendshme dhe të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme;

c) programeve, reklamave dhe spoteve për transmetim nga operatorë radiotelevizivë, fletëpalosjeve, takimeve me përfaqësues të shoqatave shqiptare jashtë vendit dhe të organizatave ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat e emigrantëve.

12. Vendimi nr. 405, datë 4.7.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave mbi detyrimin për vetëdeklarim të adresës nga shtetasit

shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe procedurave përkatëse që do të ndiqen për këtë qëllim”, shfuqizohet.

13. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

SHËRBIMI ELEKTRONIK “VETËDEKLARIMI I ADRESËS SË SHTETASVE SHQIPTARË QË JETOJNË JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

MANUALI I PËRDORIMIT

AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT 2020

Përmbajtja

1. Hyrje
2. Regjistrimi në portalin *e-Albania*
3. Përdorimi i shërbimit
1. Hyrje


Ky manual do të shërbejë si udhëzues për të gjithë shtetasit shqiptarë, të cilët jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të kryejnë procedurën e regjistrimit/identifikimit në portalin qeveritar *e-Albania* dhe të përdorin shërbimin elektronik “Deklarimi i adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”, i cili iu mundëson kryerjen e deklarimit të adresës së banimit me të dhënat e sakta në shtetin ku ata jetojnë. Formulari i vetëdeklarimit elektronik mund të plotësohet nga shtetasit për deklarimin e adresës së tyre personale ose dhe për anëtarët e së njëjtës familje, në rastin kur ata jetojnë në të njëjtën vendbanim me deklaruesin.

2. Regjistrimi në portalin qeveritar *e-Albania*


Në mënyrë që të përftoni shërbimet elektronike të ofruara nga portali qeveritar *e-Albania* duhet të identifikoheni në llogarinë tuaj në portal. Nëse nuk dispononi një llogari në portalin *e-Albania*, duhet të ndiqni udhëzimet si në vijim:

Regjistrimi në portal kryhet sipas hapave të mëposhtëm:

- Aksesoni portalin *e-Albania*, sipas URL-së: <https://e-albania.al/>.
- Klikoni “Regjistrohu”



- Shkruani tekstin në CAPTCHA në mënyre që të verifikoni që jeni person real. Më pas klikoni butonin “Vazhdo” për të përfunduar procesin e regjistrimit.



Plotësoni të gjitha të dhënat e kërkuara:

- Kodi i përdoruesit është numri personal i kartës suaj të identitetit (NID).
- Fjalëkalimi: Sigurohuni që fjalëkalimi të ketë të paktën 7 karaktere.
- *Email*: Në këtë adresë do të vijnë të gjitha njoftimet që kanë të bëjnë me aplikimet tuaja.
- Numri i celularit.
- Të dhënat personale (Emër Mbiemër Atësi). Duhet të bëhet kujdes që të gjitha të dhënat të jenë të sakta dhe të përputhen me të dhënat e Regjistrimit të Gjendjes Civile.

* *Kujdes me të dhënat që mund të kenë “ë” ose “ç”.*

Nëse edhe pas verifikimit të të dhënave tuaja në Gjendjen Civile do të keni vështirësi me regjistrimin kontaktoni me helpdesk në login@e-albania.al.

3. Përdorimi i shërbimit

Shërbimi elektronik “Deklarimi i adresës së shtetasve shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë” iu mundëson shtetasve shqiptarë, të cilët janë me vendbanim të përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të kryejnë vetëdeklarimin e adresës së banimit me të dhënat e sakta në shtetin ku ata jetojnë. Formulari i vetëdeklarimit elektronik mund të plotësohet nga shtetasit për deklarimin e adresës së tyre personale ose dhe për anëtarët e së njëjtës familje, në rastin kur ata jetojnë në të njëjtin vendbanim me deklaruesin.

Për vetëdeklarimin e adresës së shtetasve shqiptarë, të cilët jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, qytetari duhet të ndjekë këta hapa:

- Aksesoni portalin *e-Albania*, sipas URL-së: <https://e-albania.al/>.






Figura 1.1 Aksesimi i portalit *e-Albania*


- Nëse nuk jeni i regjistruar në portal, ju duhet të regjistroheni duke ndjekur udhëzimet në seksionin 2 të këtij manuali.

- Nëse jeni aktualisht i regjistruar në portal identifikohuni si qytetar nëpërmjet NID/Fjalëkalim (*Password*)





The screenshot shows the top part of the e-Albania website. At the top left is the logo 'e albania' and the date 'e mërkurë, 16 shtator 2020'. Below this is a red arrow pointing down to three selection buttons: 'Qytetar' (Citizen), 'Biznes' (Business), and 'Administrata' (Administration). Each button has a corresponding icon. Below the buttons are three small boxes with arrows pointing to the right, each containing a description of the identification method: 'Identifikimi i punonjësve qeveritarë (GOV)', 'Identifikimi i punonjësve qeveritarë me certifikatë', and 'Identifikimi i qytetarëve me lexues karte identiteti'.



The screenshot shows the login form on the e-Albania website. At the top left is the logo 'e albania' and the date 'e mërkurë, 16 shtator 2020'. Below this is the heading 'Identifikimi'. There are two input fields: the first is for the ID number, containing 'A12345678B (NID)', and the second is for the password, containing '..... (Password)'. Below the password field is a link that says 'Keni harruar fjalëkalimin tuaj?'. At the bottom of the form is a red button with a right-pointing arrow and the text 'Hyr'.

- Pasi jeni identifikuar kërkoni shërbimin **“Deklarimi i adresës së shtetasve shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”** dhe pasi të lexoni hapat e nevojshëm të procedurës, klikoni butonin **“PËRDOR”**.



Figura 1.2 Aksesimi i shërbimit online

Për të vijuar me kryerjen e aplikimit klikoni butonin "Krijo aplikim të ri"



Figura 1.3 Krijimi i një aplikimi të ri

✚ Pasi hapet formulari i aplikimit plotësoni të dhënat e detajuara të adresës së vendbanimit që jetoni aktualisht:

Formulari

Unë, i quajtur **Emër/Mbiemër** me numër personal(NID) **A123456789B** i datëlindjes **dd/mm/yyyy** me shtetësi shqiptare dhe shtetësi (shtetësia tjetër nëse kenë) deklaroj adresën aktuale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si më poshtë:

Adresa

1. Shteti *

2. Kodi postar *

3. Qyteti *

4. Rruga *

5. Numri *

6. Element të tjerë të adresës

Gjithashtu, deklaroj se në këtë adresë jetojnë edhe këta pjesëtarë të tjerë të familjes:

Nr.	Emri	Emri i babait	Mbiemri	Nr. personal	<input checked="" type="checkbox"/> Përditëso
1	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="checkbox"/> Fshi
2	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="checkbox"/> Fshi

Konsideroni vetëm pjesëtarët aktual të familjes

Shënime:

Nr. Tel Deklaruesi

E-mail

Ngarko dokumentet: (Formati JPEG, JPG)

Dokument që dëshmon ekzistencën e adresës së deklaruar *

Dokumenti zyrtar i shtetit ku jetoni në të cilin dallohet qartë emri i aplikuesit dhe adresa e plotësuar në këtë formular

Nën përgjegjësinë time ligjore, deklaroj vërtetësinë e dokumentit dhe të dhënave të plotësuara për personin tim dhe anëtarët e familjes.

Figura 1.4 Formulari i aplikimit

✚ Të dhënat që do të plotësohen automatikisht nga ndërveprimi i sistemeve janë si më poshtë:

- Emri/ Mbiemri
- NID
- Datëlindja



- [Pjesëtarët e familjes \(nëse ka anëtare të tjerë në certifikatën familjare\)](#)
- [Nr. Tel](#)
- [E-mail](#)
- [Deklaruesi](#)

✦ [Fushat që duhet të plotësohen nga aplikanti janë:](#)

- [Shteti](#)
- [Kodi postar](#)
- [Qyteti](#)
- [Rruga](#)
- [Numri](#)
- [Elementë të tjerë të adresës](#)

✦ [Ngarkoni dokumentin që dëshmon ekzistencën e adresës së deklaruar * \(Dokumenti zyrtar i shtetit ku jetoni në të cilin dallohet qartë emri i aplikuesit dhe adresa e plotësuar në këtë formular\)](#)

[Dokumenti duhet të jetë në formatin JPG, JPEG dhe jo më i madh se 500 KB.](#)

✦ [Pranoni vërtetësinë e dokumentit dhe të dhënave të plotësuar për personin tuaj dhe anëtarët e familjes dhe klikoni butonin "Dërgo" për të përfunduar aplikimin.](#)



VENDIM
Nr. 919, datë 25.11.2020

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 187, DATË 8.3.2017,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË
NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE,
ZËVENDËSMINISTRIT DHE
NËPUNËSVE TË KABINETEVE NË
DISA INSTITUCIONE TË
ADMINISTRATËS PUBLIKE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, të ndryshuar, të nenit 84, të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 64, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 1/1:

i. fjalët “... administrata gjyqësore e gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit, administrata e prokurorisë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe pranë gjykatave të apelit ...” zëvendësohen me fjalët “... nëpunësit civilë gjyqësorë dhe nëpunësit civilë të prokurorisë”;

ii. shtohet emërtesa “Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”.

b) Në fund të pikës 1/2 shtohet emërtesa “Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA)”.

c) Në shkronjën “a”, të pikës 1/3:

i. shtohet emërtesa “Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve”;

ii. emërtesa “Shkolla Shqiptare e Administratës Publike”, hiqet.

ç) Në shkronjën “b”, të pikës 1/3, emërtesa “Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar për Rininë” zëvendësohet me “Agjencia Kombëtare e Rinisë”.

d) Në pikën 4/1, fjalët “Përfshihen nga ky përjashtim nëpunësit e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” zëvendësohen me “Përfshihen nga ky parashikim nëpunësit e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe të Qendrës së Teknologjisë për Sistemin e Drejtësisë”.

dh) Pas pikës 4/18 shtohet pika 4/19, me këtë përmbajtje:

“4/19. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit, titullari i institucionit dhe, për njësitë teknike të përmbajtjes nëpunësit civilë në pozicionet, “Drejtor drejtorie”, “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist”, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.”.

e) Pika 7/1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7/1. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve civilë gjyqësorë në gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, si dhe nëpunësve civilë të prokurorisë në prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm dhe gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, janë sipas lidhjes nr. 4/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.”.

ë) Pas pikës 7/4 shtohet pika 7/5, me këtë përmbajtje:

“7/5. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” dhe “Drejtor ekzekutiv” në Qendrën për Teknologjinë e Informacionit për Sistemin e Drejtësisë, janë sipas lidhjes nr. 4/5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

f) Në lidhjen nr. 4, që përmendet në pikën 7:

i. në rreshtin e parë të kolonës “Pozicioni”, emërtesa “Kancelar i Gjykatës së Lartë”, hiqet;

ii. në fund të rreshtit të tretë të kolonës “Pozicioni” shtohet emërtesa “Kancelar i Gjykatës së Lartë”;

iii. në rreshtin e pestë të kolonës “Pozicioni” shtohet emërtesa “Kryesekretar gjyqësor”;



- iv. në rreshtin e gjashtë të kolonës “Pozicioni” shtohet emërtesa “Sekretar gjyqësor”;
- v. shtohet një rresht me këtë përmbajtje:

Këshilltar ligjor jomagjistrat në Gjykatën e Lartë	Paga bruto fillestare e gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë, pa përfitimet e tjera financiare, sipas referimeve të ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë	Sipas përcaktimeve të ligjit përkatës për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë
--	--	---

g) Në rreshtin e gjashtë të lidhjes nr. 5, që përmendet në pikën 8, shtohet emërtesa “Menaxher trajnimi në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA)”.

gj) Në lidhjen nr. 6, që përmendet në pikën 9, emërtesat “Drejtor drejtorie në drejtoritë e përmbajtjes në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike” dhe “Menaxher trajnimi në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike”, hiqen.

h) Në lidhjen nr. 6/6, që përmendet në pikën 9/6:

i. shtohet rreshti, me këtë përmbajtje:

Këshilltar në kabinetin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA.	III-a	1
--	-------	---

ii. në rreshtin e pestë të kolonës “Pozicioni”, emërtesa “Këshilltar në kabinetin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA”, hiqet.

i) Në lidhjen nr. 7/1, pjesa I, që përmendet në pikën 10/1:

i. në rreshtin e parë të kolonës “Pozicioni”, shtohet emërtesa “Dirigjent kori”;

ii. në rreshtin e katërt të kolonës “Pozicioni”, emërtesa “Dirigjent kori”, hiqet.

j) Në lidhjen nr. 9, që përmendet në pikën 12, emërtesat “Drejtor i agjencive rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve”, “Titullar i qendrave rajonale rinore”, “Përgjegjës sektori në agjencitë rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve”, “Përgjegjës sektori në qendrat rajonale rinore”, “Specialist në agjencitë rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve” dhe “Specialist në qendrat rajonale rinore”, hiqen.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2020, të përballohen nga fondet e secilit institucion, për këtë vit dhe të fillojnë:

a) nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, për nëpunësit civilë të prokurorisë, Gjykatën e Lartë, Shkollën Shqiptare të Administratës Publike,

Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit, Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblin Popullor;

b) nga momenti i emërimit të nëpunësve, për Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Agjencinë Kombëtare të Rinisë;

c) nga momenti i përcaktimit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor të kategorive të kancelarëve bazuar në ngarkesën dhe nivelin e çdo gjykate, për nëpunësit civilë gjyqësorë të gjykatave të apelit dhe gjykatave të shkallës së parë;

ç) nga momenti i fillimit të funksionimit të plotë të Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Agjencisë Kombëtare të Rinisë, për, përkatësisht, agjencitë rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Shërbimin Kombëtar për Rininë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



Lidhja nr. 4/1

**KATEGORITË E PAGAVE TË POZICIONEVE TË PUNËS SË NËPUNËSVE CIVILË
GJYQËSORË NË GJYKATAT E APELIT DHE GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË, SI DHE
NË PROKURORITË PRANË GJYKATAVE TË APELIT ME JURIDIKSION TË
PËRGJITHSHËM DHE GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË ME JURIDIKSION TË
PËRGJITHSHËM**

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT
Pjesa I – Niveli i parë i gjykatave të apelit dhe gjykatave të shkallës së parë, si dhe i prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe gjykatave të shkallës së parë, sipas përcaktimit përkatësisht të KLGJ-së dhe Prokurorit të Përgjithshëm		
Kancelar.	II-a	1
Drejtor drejtorie Ndihmësligjor në gjykatat e apelit	II-b	1
Kryesekretar Përgjegjës sektori	III-a	1
Përgjegjës sektori	III-a/1	1
Sekretar gjyqësor Sekretar në sekretarinë e prokurorisë Specialist	III-b	1 ose 2
Specialist	IV-a	1 ose 2, ose 3
	IV-b	
Pjesa II – Niveli i dytë i gjykatave të apelit dhe gjykatave të shkallës së parë, si dhe i prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe gjykatave të shkallës së parë, sipas përcaktimit përkatësisht të KLGJ-së dhe Prokurorit të Përgjithshëm		
Kancelar Ndihmësligjor në gjykatat e apelit	II-b	1
Drejtor drejtorie	III-a	1
Kryesekretar Përgjegjës sektori	III-a/1	1
Sekretar gjyqësor Sekretar në sekretarinë e prokurorisë	III-b	1 ose 2
Specialist	IV-a	1 ose 2, ose 3
	IV-b	
Pjesa III – Niveli i tretë i gjykatave të apelit dhe gjykatave të shkallës së parë, si dhe i prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe gjykatave të shkallës së parë, sipas përcaktimit përkatësisht të KLGJ-së dhe Prokurorit të Përgjithshëm		
Ndihmës ligjor në gjykatat e apelit	II-b	1
Kancelar	III-a	1
Kryesekretar Përgjegjës sektori	III-b	1
Sekretar gjyqësor Sekretar në sekretarinë e prokurorisë Specialist	IV-a	1 ose 2, ose 3
Specialist	IV-b	1 ose 2, ose 3



Lidhja nr. 4/5

KATEGORITË E PAGAVE DHE SHITESAT PËR KUSHTE PUNE TË POZICIONEVE TË PUNËS SË NËPUNËSVE PËR EMËRTESAT “SPECIALIST” DHE “DREJTOR EKZEKUTIV” NË QENDRËN PËR TEKNOLOGJINË E INFORMACIONIT PËR SISTEMIN E DREJTËSISË

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT	SHITESA PËR KUSHTE PUNE
Drejtor ekzekutiv	II-b	1	20.000
Specialist	III-b	1 ose 2	25.000

VENDIM

Nr. 920, datë 25.11.2020

PËR TRAJTIMIN ME PAGË E SHITESA MBI PAGË DHE PËR PROCEDURËN E KOMPENSIMIT FINANCIAR GJATË QËNDRIMIT NË PUNË TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË BURGJEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 80/2020, “Për Policinë e Burgjeve”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. PAGA DHE SHITESAT MBI PAGË**

1. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Burgjeve janë, si më poshtë vijon:

a) Paga bazë mujore për gradë, që është niveli i pagës së punonjësit, në përputhje me gradën që ka fituar brenda rolit përkatës. Vlera e pagës bazë mujore për gradë përcaktohet në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Shtesa për natyrë të veçantë pune, që është shtesa për shkak të natyrës së punës, për kohën që ushtrojnë detyrat funksionale (sipas funksioneve/ pozicioneve të miratuara në organikë) dhe që përcaktohet:

i. në lidhjen nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale;

ii. në lidhjen nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për punonjësit e Policisë së Burgjeve në aparatit e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

c) Shtesa për vjetërsi në shërbim, që është shtesa që përfiton punonjësi i Policisë së Burgjeve me grada, për kohën e qëndrimit në gradë, në masën 1 për qind, pas çdo viti pune. Llogaritja e shtesës për vjetërsi shërbimi bëhet mbi pagën e gradës “Nëninspektor”, të rolit bazë.

2. Për efekt të llogaritjes së shtesës për vjetërsi në shërbim, sipas shkronjës “c”, të pikës 1, të këtij kreu, konsiderohen vitet e qëndrimit në gradë të dokumentuara në librezën e punës së çdo punonjësi në strukturat e Policisë së Burgjeve, Policisë së Shtetit, Forcave të Armatosura, Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat dhe Shërbimit Informativ të Shtetit, sipas ekuivalentimit në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

3. Vitet që përjashtohen nga llogaritja e shtesës së vjetërsisë së shërbimit vetëm për efekt pagese janë vitet e sigurimit vullnetar, të vetëpunësimit, vitet e punës si punonjës pa gradë, vitet e shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit ushtarak të Ministrisë së Brendshme, të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe periudhat e trajtimit me pagesë papunësie apo pagesë kalimtare.



II. KOMPENSIMI PËR SHPENZIMET E UDHËTIMIT

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, kur transferohet ose komandohet jashtë vendbanimit të tij, në rast pamundësie të garantimit nga institucioni të transportit nga vendbanimi deri në vendin e punës, përfiton kompensim për shpenzimet e udhëtimit.

2. Masa e kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit, sipas pikës 1 të këtij kreu, përcaktohet në varësi të distancës në kilometra, të vendit të punës me vendbanimin e punonjësit, si më poshtë vijon:

Distanca në kilometra	Masa e kompensimit në lek për muaj
Nga 36 km deri 60 km	3 000 lekë/muaj
Nga 61 km deri 100 km	5 000 lekë/muaj
Nga 101 km deri 150 km	8 000 lekë/muaj
Nga 151 km deri 200 km	10 000 lekë/muaj
Mbi 200 km	15 000 lekë/muaj

3. Për përfitimin e kompensimit për shpenzimet e udhëtimit, punonjësi paraqet në institucionin ku është transferuar dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën me shkrim, pranë institucionit ku është i punësuar punonjësi;

b) fotokopjen e kartës së identitetit;

c) certifikatën e gjendjes familjare;

ç) vërtetimin nga njësia e vetëqeverisjes vendore, për vendbanimin e familjes dhe të vetë punonjësit, pavarësisht nga gjendja civile;

d) vërtetimin nga zyra vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, nëse punonjësi është pronar i një banese në territorin e bashkisë ku ndodhet institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale, ku ai është transferuar ose komanduar;

dh) vërtetimin nga zyra vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, nëse punonjësi ka aplikuar për legalizim banese në territorin e bashkisë ku ndodhet institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale ku ai është transferuar ose komanduar.

4. Titullari i njësisë shpenzuese verifikon nëpërmjet strukturave të institucionit vërtetësinë e dokumentacionit të përcaktuar në pikën 3, të këtij kreu, të paraqitur nga punonjësi.

5. Punonjësi i Policisë së Burgjeve përfiton kompensim për shpenzimet e udhëtimit, në masën dhe sipas rregullave të përcaktuara në këtë krye, deri në momentin e sistemimit me banesë në

territorin e bashkisë ku ndodhet institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale, ku ai është transferuar ose komanduar.

III. KOMPENSIMI PËR QIRANË E BANESËS

1. Kur punonjësi i Policisë së Burgjeve transferohet ose komandohet jashtë vendbanimit të tij të përhershëm, për shkak të detyrës ose për nevoja pune, kompensohet për qiranë e banesës, në rastet kur fjetja, transporti dhe ushqimi nuk sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Këtë kompensim punonjësi e përfiton nëse transferohet ose komandohet në largësi mbi 36 km.

2. Masa e kompensimit për qira banese, për punonjësin e Policisë së Burgjeve sipas përcaktimit të pikës 1, të këtij kreu, në varësi të personave në ngarkim që ka punonjësi, është, si më poshtë vijon:

Numri i personave në ngarkim	Sipërfaqja e banesës për të cilën i kompensohet qiraja e banimit
I vetëm	43.93 m ²
Punonjësi dhe një person në ngarkim	56.47 m ² ;
Punonjësi dhe dy persona në ngarkim	79.74 m ² ;
Punonjësi dhe tre persona e më shumë, në ngarkim	80.50 m ² .

3. Numri i personave, pjesëtarë të familjes, në ngarkim të punonjësit të Policisë së Burgjeve, vërtetohet nëpërmjet certifikatës së gjendjes familjare.

4. Njësia shpenzuese në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve bën kompensimin e qirasë së banesës së punonjësit të Policisë së Burgjeve, përkundrejt paraqitjes së kontratës së qirasë, në vlerë jo më të madhe se vlera minimale e qirasë, e përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore. Vlera minimale mujore e çmimit të shitjes për metër katror sipërfaqe ndërtese të dhënë me qira do të përlllogaritet në bazë të vlerës mesatare të shitblerjeve së banesave në tregun e lirë, sipas njësive administrative, të përcaktuara në udhëzimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”, që miratohet çdo vit.



5. Për përfitimin e kompensimit për qira banese, sipas pikave 1 deri në 4, të këtij kreu, punonjësi paraqet në institucionin ku është transferuar, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën me shkrim, pranë njësisë buxhetore ku është i punësuar;

b) fotokopjen e kartës së identitetit;

c) certifikatën e gjendjes familjare;

ç) kontratën e noterizuar të qirasë së banesës në territorin e bashkisë ku ndodhet institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale ku punonjësi është transferuar ose komanduar;

d) vërtetimin nga zyra vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës që punonjësi nuk ka banesë në territorin e bashkisë ku ndodhet institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale ku ai është transferuar ose komanduar;

dh) vërtetimin nga zyra vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës që punonjësi nuk ka aplikuar për legalizim banese në territorin e bashkisë ku ndodhet institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale ku ai është transferuar ose komanduar.

6. Titullari i njësisë shpenzuese verifikon, nëpërmjet strukturave të varësisë, vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur nga punonjësi dhe zbatimin e kontratës së qirasë.

7. Përcaktimi i apartamentit të banimit, që punonjësi i Policisë së Burgjeve do të marrë me qira, si dhe i masës së pagesës së qirasë, sipas përcaktimeve në këtë krye, bëhet nga një komision vlerësimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, i cili përzgjedh ofertën më të leverdisshme, mbi bazën e shqyrtimit të 3 (tre) ofertave të marra nga ky punonjës, nga 3 (tre) shoqëri imobiliare.

8. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, pasi merr miratimin për ofertën e përzgjedhur, sipas përcaktimit në pikën 7, të këtij kreu, nënshkruan kontratën e qirasë së apartamentit të banimit për një periudhë 6-mujore, me të drejtë ripërtëritjeje me të njëjtat kushte. Kontrata e qirasë, detyrimisht, duhet të bëhet në një zyrë noteriale.

9. Procedurat standarde të punës për verifikimin e vërtetësisë së dokumentacionit të paraqitur nga punonjësi i Policisë së Burgjeve, të lidhjes dhe zbatimit të kontratës së qirasë dhe pagesës së qirasë së banesës, sipas përcaktimeve të këtij kreu, miratohen me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

10. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, që përfiton kompensim për qiranë e banesës, nuk përfiton kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit.

11. Fondi i përcaktuar për kompensimin e qirave të banesave, sipas parashikimeve të këtij kreu, planifikohet çdo vit në programin buxhetor të Policisë së Burgjeve.

12. Përfitimi i kompensimit për qiranë e banesës vazhdon deri në ndryshimin e vendbanimit të punonjësit, që nënkupton sistemimin me banesë në territorin e bashkisë ku ndodhet institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale, ku ai është transferuar ose komanduar.

IV. TRAJTIMI ME USHQIM PA PAGESË OSE KOMPENSIMI I SHPENZIMEVE TË USHQIMIT

1. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve i siguron punonjësit të Policisë së Burgjeve, në rastet kur transferohet ose komandohet jashtë vendbanimit, trajtimin me ushqim pa pagesë:

a) me një vakt, kur kohëzgjatja e punës së punonjësve të Policisë së Burgjeve është 8 (tetë) orë;

b) me tri vakte, kur punonjësit e Policisë së Burgjeve janë të angazhuar në shërbime apo gatishmëri dhe kohëzgjatja e shërbimit ose e gatishmërisë zgjat 24 (njëzet e katër) orë.

2. Normat e ushqimit ditor të kalorive, për të gjithë punonjësit përfitues sipas pikës 1, të këtij kreu, miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për policinë e burgjeve dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë, ku përcaktohen:

a) normat e artikujve ushqimorë, brenda limitit të miratuar të kalorive, duke ruajtur raportin e njësive ushqimore;

b) normat e zëvendësimit të artikujve ushqimorë;

c) normat e pajisjeve dhe të materialeve të shërbimit të ushqimit.

3. Në rastet kur Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nuk siguron trajtimin me ushqim pa pagesë, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij kreu, punonjësit të Policisë së Burgjeve i jepet një kompensim në vlerë monetare për shpenzimet e ushqimit, për ditët efektive të punës. Vlera e kompensimit (në lek) të shpenzimeve të ushqimit, bëhet bazuar në normën e përcaktuar ushqimore, dhe miratohet nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve.



4. Punonjësi i Policisë së Burgjeve përfiton trajtimin me ushqim pa pagesë apo kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, sipas këtij kreu, deri në momentin e sistemit me banesë në territorin e bashkisë ku ndodhet institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale, ku ai është transferuar ose komanduar.

5. Fondi i përcaktuar për këtë qëllim planifikohet për çdo vit në programin buxhetor të Policisë së Burgjeve.

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet buxhetore të planifikuara për Policinë e Burgjeve dhe fillojnë:

a) për parashikimet e lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi, nga data 7 gusht 2020;

b) për aplikimin e shtesës për vjetërsi shërbimi, për çdo vit të qëndrimit në gradë, nga data 1 janar 2021;

c) për zbatimin e shtesave për natyrë të veçantë pune, sipas lidhjeve nr. 2 dhe nr. 3, bashkëlidhur këtij vendimi, nga data 1 janar 2022.

2. Punonjësit e Policisë së Burgjeve, deri në datën 1 janar 2022, do të vazhdojnë të përfitojnë shtesën për natyrë të veçantë pune e shërbimi sipas përcaktimit në vendimin nr. 201, datë 15.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të Policisë së Burgjeve”, të ndryshuar.

3. Vendimi nr. 201, datë 15.3.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të policisë së burgjeve”, të ndryshuar, shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 1

PAGA BAZË MUJORE PËR GRADË PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË BURGJEVE

Roli	Grada	Paga bazë për gradë
1	2	3
Bazë	Aspirant	40000
	Nëninspektor	45500
	Inspektor	50000
	Kryeinspektor	55000
I mesëm	Nënkomisar	65500
	Komisar	72000
	Kryekomisar	95000
I lartë	Drejtues	106700
	Drejtues i Lartë	115000



								MAILINDA	IBRAHIM	MURTHI						
								MYRTEZA	IBRAHIM	MURTHI						
								VJOLLCA	MALIQ	MURTHI						
								XHELAL	MALIQ	MURTHI						
								YLLKA	MALIQ	MURTHI						
								FATMIR		MURTHI						
								KLEA	BASHKIM	PINARI						
								BASHKIM	SALI	PINARI						
								JEMINE	MEHMET	KORCA						
								AFRIM	MEHMET	KORCA						
								MUSTAFA	MEHMET	KORCA						
								RAJMONDA	MEHMET	KORCA						
								LULZIM	MALIQ	MURTHI						
								LEJLA	BESIM	OGRANAJA						
								FATBARDHA	ISUF	MURTHI						
								TANSEL	LULZIM	KORCA						
								DANIELA	LULZIM	KORCA						
								LIRI	MEHMET	LEKA						
								HASAN	MEHMET	FAJA						
								HAMDI	MEHMET	FAJA						
								DHURATA	MEHMET	FAJA						
													<i>LIDHJAM</i>			
													<i>VKM NR. 182, DATË 4.4.2019</i>			
													<i>QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN, ZONA KADASTRALE 8527</i>			
20	ISHTE	XHEVIT	IBRAHIM	SADIU	9974356	7/7/2016		AGRON	TEKI	TELA	174/57	287.5	12,764.00	3,669,650.00		
								ANITA	MASAR	ALICKA						
								BULENT	TEKI	TELA						
								EDMOND	TEKI	TELA						
								FELATUN	MAZLLEM	KARAISKAJ						
								GJERAK	MAZLLEM	KARAISKAJ						
								HAJALI	ISMAIL	YPI						
								LAVDIJE	SKENDER	KALASA						
								NEBI	ISMAIL	SEFA						
								NEFIJE	TEKI	SELENICA(TELA)						
								SHAZIVAR	MASAR	KARAO SMANI						
								SHEGUSH	MASAR	KOSOVA						
								TEUTA	SKENDER	FOR A						
								XHANETA	ISMAIL	PRODANI						
								AGRON	TEKI	TELA						
								ANITA	MASAR	ALICKA						
								BULENT	TEKI	TELA						
								EDMOND	TEKI	TELA						
								FELATUN	MAZLLEM	KARAISKAJ						
								GJERAK	MAZLLEM	KARAISKAJ						
								HAJALI	ISMAIL	YPI						



									LAVDIJE	SKENDER	KALASA					
									NEBI	ISMAL	SEFA					
									NESEFIJE	TEKI	SELENICA(TELA)					
									SHAZIVAR	MASAR	KARAOSMANI					
									SHEGUSH	MASAR	KOSOVA					
									TEUTA	SKENDER	FORA					
									XHANETA	ISMAL	PRODANI					
									SUHELA	XHEVDET	LIBOHOVA					

LIDHJA N

VKM NR. 355, DATE 29.4.2020

QARKU KUKËS, ASHK KUKËS ZONA KADASTRALE 2762

21	ISHTE	JAHIR	ABDULLAH	GASHI	39198	6.25.2018	152.28	HAMDI	ISUP	GASHI	275/17	152.28	203	30,912.84	Urdhër nr. 154, datë 15.5.2018 i regjistruerit: "Të kufizohet pasuria nr. 275/17, truall, regjistruar në volum 3, faqe 239, në pronësi të Hamdi Isuf Gashi, deri në kthimin e sipërfaqes mbi normë prej 300 m ² "
	BËHET	JAHIR	ABDULLAH	GASHI	39198	25.6.2018			ANULOHEJ						

1	Korigjimi	Emeri	Atesia	Mbiemri	NR. PRONAVE	QARKU	Numri i zonës kadastrale	Numri i pasurisë	Sipërfaqja e parcelës që do të shpërblehet (m2)	Vlera truallit sipas AKKP-se	Vlera e shpërblimit (tekë)				
---	-----------	-------	--------	---------	-------------	-------	--------------------------	------------------	---	------------------------------	----------------------------	--	--	--	--

LIDHJA O

VKM NR. 204, DATE 19.2.2009

QARKU TIRANË, ASHK TIRANA JUG ZONA KADASTRALE 8220

BËHET	ISHTE	LEJLA	SHEFQET	LIBOHOVA		TIRANË	8220	1/184	190	28659	5445210				
		GEZIM	HAXHI	IACELLI			190								
		ARBEN	PERTREF	TELI			0.0	LEJLA	SHEFQET	LIBOHOVA	1/184	190	28659	5445210	Korigjimi bëhet për efekt të saktësimit të pozicionit në fakt të pasurisë. Saktësim HTR
		ARTAN	PERTREF	TELI											
		VALBONA	PERTREF	TELI											
		PERTEF	SEFER	TELI											
		RESHIT	MUSLIM	GIJONA			0.0								
	ERION	RESHIT	GIJONA												

LIDHJA P

VKM NR. 389, DATE 19.5.2010

QARKU TIRANË, ASHK TIRANA JUG ZONA KADASTRALE 8190

23	ISHTE	FERUZE		BILBILI		TIRANË	8190	7/393	390.30	27,104.0	10,578,691.2				
		BUKUROSH		BILBILI											
		FATMIR		BILBILI											
		QEMALTOMI		BILBILI											
		GJYLISHE		BILBILICACI											
		HAVA		BILBILKOTRRI											
		SHYQYRI		BILBILI											
	BËHET	ARBEN	XHEMAL	RUKAJ	7/790	98.6	98.6	FERUZE		BILBILI					
		SKENDER	KAPLLAN	DEMIRAJ	7/435	112.2	112.2	BUKUROSH		BILBILI					
		SHKURT	GANI	KARAJ	7/490	22.7	22.7	FATMIR		BILBILI					
		ALTIN	SHKURT	KARAJ	7/433	128	128	QEMALTOMI		BILBILI	7/393	361.5	27104	9798096	Korigjimi bëhet për efekt të saktësimit të pozicionit në fakt të pasurisë. Saktësim HTR
		KUJTIM	AZEM	BEBJA	7/433	361.5	361.5	GJYLISHE		BILBILICACI					
								HAVA		BILBILKOTRRI					
								SHYQYRI		BILBILI					

ANULIM VKM KALIM PRONËSIE



NR. RENDOR	DREJTORIA	KORRIGJIMI	EMËR	ATËSI	MBIEMËR	NR. PROTOKOLLI I VETËDEKLARIMIT PËR LEGALIZIM	ZONA KADASTRALE	NUMRI I PASURISË	SIPËRFAQJA E PARCELËS NDËRTIMORE PËR KALIM PRONËSIE (m ²)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11
LIDHJA Q									
VKM NR. 450, DATË 6.5.2009									
24	ELBASAN	ishte bëhet	SPIRO	NIAZI	HAMATI	356	2124	336/10	499.4
ANULOHET									
LIDHJA R									
VKM NR. 1038, DATË 14.10.2009									
25	TIRANA JUG	ishte bëhet	ZEF	GJERGJ	GJOKA	573	8230	2/627	256.6
ANULOHET									
LIDHJA S									
VKM NR. 125, DATË 17.2.2010									
26	RURALE 1	ishte bëhet	DAUT	MUSA	KUPA	927	2704	606/102	349.3
ANULOHET									
LIDHJA T									
VKM NR. 279, DATË 01.04.2015									
27	TIRANA VERI	ishte bëhet	ENIO	FERIZ	IAHELEZI	763	8240	2/301	600
ANULOHET									
28	SHKODËR	ishte bëhet	TOM	NIKOLL	KOCI	575	8593	6/1003	174
ANULOHET									
LIDHJA U									
VKM NR. 42, DATË 21.1.2015									
29	FIER	ishte bëhet	FEJZI	NAZIF	HOXHAI	76	3981	117/812	346.5
ANULOHET									

**VENDIM****Nr. 923, datë 25.11.2020****PËR FUNKSIONIMIN E ORGANIZIMIN
E KOMITETIT TË MBROJTJES CIVILE
DHE BASHKËPUNIMIN
NDËRINSTITUCIONAL TË
INSTITUCIONEVE DHE TË
STRUKTURAVE TË SISTEMIT TË
MBROJTJES CIVILE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 20, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pranë Këshillit të Ministrave krijohet e funksionon Komiteti i Mbrojtjes Civile (në vijim, KMC), i cili është organi më i lartë, i përhershëm, përgjegjës për zbatimin e politikave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në Republikën e Shqipërisë.

2. KMC-ja kryesohet nga ministri i Mbrojtjes dhe ka në përbërje:

- ministrin e Brendshëm;
- ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- ministrin e Financave dhe Ekonomisë;
- ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- ministrin e Turizmit dhe Mjedisit;
- ministrin e Drejtësisë;
- ministrin e Kulturës;
- drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile;
- drejtorin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore;
- drejtorin e Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore;
- kryetarin e Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha.

Në varësi të nevojave, në mbledhjet e KMC-së ftohen edhe përfaqësues nga institucione shkencore dhe monitoruese, drejtues të strukturave qendrore, organizata joqeveritare etj.

3. KMC-ja mblidhet, sa herë gjykohet e nevojshme nga kryetari i tij, për çështje që kanë të

bëjnë me zbatimin e politikave në bashkërendimin e punës për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive dhe mbrojtjen civile. Të drejtën e propozimit për thirrjen e mbledhjes së KMC-së, përveç kryetarit të tij, e ka edhe çdo ministër, sipas fushës së përgjegjësisë dhe llojit të fatkeqësisë.

4. KMC-ja zbaton politikat që kanë të bëjnë me vlerësimin e riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror, Strategjinë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe Planin Kombëtar të Emergjencave Civile dhe, nëpërmjet ministrit përgjegjës për mbrojtjen civile, propozon ndryshime apo përditësime të tyre.

5. KMC-ja është autoriteti më i lartë i përhershëm që bashkërendon e koordinon veprimtaritë dhe aktivitetet ndërinstitucionale të institucioneve e të strukturave dhe të të gjitha subjekteve të përfshira në mbrojtjen civile.

6. KMC-ja, me kërkesë të prefektit, në rast se vlera e kompensimit tejkalon 8 (tetë) % të buxhetit të bashkisë, merr vendim për kompensimin e dëmeve nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.

7. Pranë AKMC-së ngrihet e funksionon sekretariati teknik i KMC-së, i cili është përgjegjës për përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe për njoftimin e anëtarëve të KMC-së për mbledhjen e radhës, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë përpara datës së zhvillimit të saj. Përbërja e sekretariatit teknik të KMC-së përcaktohet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

8. Çdo ministër është përgjegjës për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, në fushën e përgjegjësisë shtetërore të institucionit që drejton, nëpërmjet sektorit për mbrojtjen civile. Ministrinë hartojnë plane, programe e dokumente të tjera që kanë për qëllim zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, sipas llojit të veprimtarisë e përgjegjësisë së tyre.

9. AKMC-ja koordinon në mënyrë të përqendruar shpërndarjen e kapaciteteve logjistike dhe njerëzore, të caktuara për përballimin e emergjencave civile apo të fatkeqësive.

10. Sektorët për mbrojtjen civile pranë ministrive duhet të zbatojnë me shpejtësi dhe efektivitet kërkesat e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për përballimin e emergjencave civile apo të fatkeqësive.



11. Sektorët për mbrojtjen civile në ministrinë përkatëse aktivizojnë, me kërkesë të AKMC-së, kapacitetet e parashikuara për emergjencë civile, për të reaguar me shpejtësi dhe efektivitet në rastin më të parë të mundshëm, por asnjëherë më vonë se 2 (dy) orë.

12. Në situatat e emergjencave civile, komunikimi ndërinstitucional mbahet duke përdorur kanalet zyrtare të komunikimit. Në rastet e komunikimit verbal, sektorët për mbrojtjen civile pranë ministrive regjistrojnë dhe ruajnë përmbajtjen e bisedave, të njoftimeve apo të kërkesave të marra e të dhëna përmes përdorimit të mjeteve të teknologjisë së informacionit.

13. Institucionet dhe strukturat operacionale kryesore shtetërore, përgjegjëse për përballimin e emergjencave civile apo të fatkeqësive, janë ato të përcaktuara në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të cilat angazhohen menjëherë me kërkesë të AKMC-së.

14. Për përballimin e emergjencave civile me specifika të veçanta, me kërkesë të AKMC-së, mund të angazhohen edhe autoritete e institucione të tjera shtetërore, përveç atyre të parashikuara në lidhjen 1 të këtij vendimi.

15. Institucionet e strukturat vendore, që bashkëpunojnë me institucionet dhe strukturat qendrore dhe të tjera për mbrojtjen civile, janë komisionet e mbrojtjes civile në nivel qarku e bashkie, të cilat veprojnë nën drejtimin e prefektit të qarkut e të kryetarit të bashkisë.

16. Në përbërje të strukturës së administratës së prefektit funksionon Sektori i Planifikimit dhe Mbrojtjes Civile. Prefekti bashkërendon me bashkitë brenda territorit administrativ të tij për planifikimin pranë tyre të strukturave të përhershme të planifikimit e të mbrojtjes civile.

17. Komunikimi me publikun, në rastet e fatkeqësive natyrore/fatkeqësive, kryhet nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen civile.

18. Vendimi nr. 965, datë 2.12.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit, në rastet e emergjencave civile dhe krizave”, shfuqizohet.

19. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e

Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Kulturës, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe të gjitha institucionet, sipas lidhjes 1, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja 1

STRUKTURAT OPERACIONALE KRYESORE TË AUTORITETEVE DHE TË INSTITUCIONEVE SHTETËRORE PËRGJEGJËSE PËR PËRBALLIMIN E EMERGJENCAVE CIVILE DHE TË FATKEQËSIVE

Ministria e Mbrojtjes:

1. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile;
2. Strukturat e Mbrojtjes Rajonale (Batalioni i Mbështetjes Rajonale) Kukës, Shkodër, Mat, Gjirokastrë, Berat, Korçë pranë Shtabit të Përgjithshëm të FA-së;
3. Grupet e helikopterëve në Bazën Ajrore Farkë/ Njësia e Transportit Mjekësor me Helikopterë/Sektori i Helikopterëve të Repartit Special RENEA;
4. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit;
5. Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit;
6. Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare.

Ministria e Brendshme:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
2. Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi;
3. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
2. Drejtoria e Strehimit.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë:

1. Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Transportit, Infrastrukturës dhe Zhvillimit Urban;
2. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar;
3. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera;



4. Autoriteti Rrugor Shqiptar;
5. Instituti i Ndërtimit;
6. Organi Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore në Aviacionin Civil;
7. Drejtoria e Përgjithshme e Ujësllës – Kanalizimeve;
8. Drejtoria e Përgjithshme Detare;
9. Agjencia Kombëtare Bërthamore;
10. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore;
11. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit;
12. OSHEE-ja, OST-ja, KESH-i.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural:

1. Drejtoritë e seksionit bujqësor;
2. Drejtoritë e ujitjes dhe kullimit;
3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit;
4. Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare (ISUV).

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit:

1. Agjencia Kombëtare e Turizmit (AKT);
2. Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB);
3. [Agjencia Kombëtare e Mjedisit](#);
4. [Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura](#).

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:

1. Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë;
2. Instituti i Shëndetit Publik;
3. Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet (ZMR), pranë Institutit të Shëndetit Publik (ISHP);
4. Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut;
5. Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore;
6. Njësitë vendore të Kujdesit Shëndetësor;
7. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet;
8. Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore;
9. Shërbimi Social Shtetëror.

Ministria e Drejtësisë:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Ministria e Kulturës:

1. Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore;
2. Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Tiranë;
3. Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë;
4. Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Berat;

5. Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Korçë;
6. Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Vlorë;
7. Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Shkodër.

Universiteti Politeknik i Tiranës:

1. Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM).

Universiteti i Tiranës:

1. Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar.

VENDIM

Nr. 924, datë 25.11.2020

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT E TË PROCEDURËS PËR PAJISJEN, RIPËRTËRITJEN, REFUZIMIN DHE ANULIMIN E LEJES SË PUNËS, SI PUNONJËS ME KUALIFIKIM TË LARTË, TË TIPIT “A/KL”¹, SI DHE TË TARIFËS SHTETËRORE PËR LËSHIMIN E KËSAJ LEJEJE PUNE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 71, pika 8, 86, pika 2, e 105, pika 1, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të huajt i jepet leje pune e tipit “A/KL”, për herë të parë, me një afat jo më pak se 1 (një) vit, si punonjës me kualifikim të lartë, nëse plotëson kriteret e përcaktuara në pikën 1, të nenit 98, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar.

2. Të huajt i ripërtërihet leja e punës e tipit “A/KL”, si punonjës me kualifikim të lartë, për 2 (dy) herë radhazi me një afat dyvjeçar e më pas me afat të përhershëm, nëse është në përputhje me parashikimin e pikës 1, të nenit 76, të ligjit nr.

¹ Ky vendim i Këshillit të Ministrave përafrohet pjesërisht me direktivën e Këshillit 2009/50/KE, datë 25.5.2009, “Mbi kushtet e hyrjes dhe të qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta me qëllim pune tepër të kualifikuar”, numri CELEX 32009L0050, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian.



108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar, si dhe nëse plotëson kriteret e mëposhtme:

a) ka një kontratë pune të vlefshme, në përputhje me formimin e tij profesional, për një afat dyvjeçar, por jo domosdoshmërisht me punëdhënësin, që ka përfituar lejen e parë të tipit “A/KL”;

b) plotëson kushtet e shkronjave “b”, “c”, dhe “ç”, të pikës 1, të nenit 98, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar;

c) është me qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Kërkesa për t’u pajisur me leje pune të tipit “A/KL” bëhet nga subjektet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 71, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar.

4. Subjektet e përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, për t’u pajisur për herë të parë me leje pune të tipit “A/KL”, paraqesin kërkesën e tyre përmes shërbimit elektronik në portalin *e-Albania*, bashkë me dokumentacionin e mëposhtëm, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të njëzuar me origjinalin nga noteri:

a) kërkesën e të huajt me të dhënat personale, sipas formatit të dhënë në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) kopjen origjinale të kontratës individuale të punës, ku të plotësohen kushtet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi;

c) dokumente që vërtetojnë kualifikimet e larta profesionale në profesionin apo në sektorin e përcaktuar në kontratën e punës;

ç) kopjen e pasaportës;

d) prokurën apo autorizimin nga i huaji apo punëdhënësi, nëse aplikimi kryhet nëpërmjet një përfaqësuesi të autorizuar;

dh) kërkesën e paraqitur në institucionet përkatëse, për t’u siguruar në skemat e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;

e) një fotografi të aplikuesit, të bërë jo më përpara se 6 (gjashtë) muaj nga data e aplikimit, me përmasa 47 mm x 36 mm, të marra në plan me sfond të bardhë, të fokusuara dukshëm e qartë. Fotografia duhet të tregojë personin përballë, me qëndrim neutral e sytë të hapur e të dukshëm.

5. Personat e përcaktuar në pikën 3, të këtij vendimi, për t’u pajisur me leje pune të ripërtëritur të tipit “A/KL”, paraqesin, nëpërmjet shërbimit elektronik të portalit *e-Albania*, brenda 30 (tridhjetë) ditëve para mbarimit të afatit të lejes ekzistuese,

kërkesën e dokumentacionin e mëposhtëm, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të njëzuar me origjinalin nga noteri:

a) kërkesën e të huajt me të dhënat personale;

b) kopjen e kontratës individuale të punës me afatin kohor të përcaktuar të paktën deri në 2 (dy) vjet, për 2 (dy) ripërtëritjet e para;

c) prokurën apo autorizimin nga i huaji apo punëdhënësi, nëse aplikimi kryhet nëpërmjet një përfaqësuesi të autorizuar;

ç) një fotografi të aplikuesit, të bërë jo më përpara se 6 (gjashtë) muaj nga data e aplikimit, me përmasa 47 mm x 36 mm, të marra në plan me sfond të bardhë, të fokusuara dukshëm e qartë. Fotografia duhet të tregojë personin përballë, me qëndrim neutral e sytë të hapur e të dukshëm.

6. Kërkesa dhe dokumentacioni i përcaktuar në pikat 3 e 4, të këtij vendimi, i drejtohet strukturës përkatëse të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA), në territorin e së cilës kryhet aktiviteti.

7. Struktura përkatëse e AKPA-së, pasi shqyrton dokumentacionin e paraqitur dhe vlerëson se ai nuk është në përputhje me kërkesat e pikës 4, të këtij vendimi, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e aplikimit, i kërkon të huajt plotësimin e tij, brenda 10 (dhjetë) ditëve punë.

8. Struktura përkatëse e AKPA-së, pas paraqitjes së kërkesës nga personat e përcaktuar në pikën 3, të këtij vendimi, verifikon të dhënat e punëdhënësit, të regjistruar në QKB, statusin “aktiv”, si dhe shlyerjen e detyrimeve lidhur me pagat e punonjësve, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore nga ana e punëdhënësit, pranë të cilit do të punësohet i huaji.

9. Nëse struktura përkatëse e AKPA-së vlerëson se dokumentacioni i paraqitur është i plotë apo pas plotësimit të tij nga personat e përcaktuar në pikën 3, të këtij vendimi, brenda afatit të përcaktuar, përmbush kriteret e përcaktuara në pikat e këtij vendimi, e pajis të huajin, brenda 10 (dhjetë) ditëve punë, me leje pune të tipit “A/KL”, për herë të parë, sipas formatit të dhënë në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi. E njëjta procedurë ndiqet edhe në rastin e shqyrtimit të dokumentacionit për ripërtëritjen e lejes së punës. Struktura përkatëse e AKPA-së e njofton në mënyrë elektronike kërkuuesin, që të dërgojë me postë dokumentacionin origjinal, si dhe çdo dokument të listuar në pikat 4 apo 5, të këtij



vendimi, në një kopje dhe 3 (tri) fotografi, sipas përshkrimit, e më pas, po në atë adresë postare, i dërgohet kopja origjinale e lejes së punës.

10. Struktura përkatëse e AKPA-së ia refuzon kërkesën për pajisje me leje pune të tipit “A/KL” punëmarrësit, i cili, megjithëse ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar, vlerësohet se nuk plotëson kriteret e përcaktuara në pikat 1 e 8 të këtij vendimi.

11. Të huajt i refuzohet lëshimi i lejes së punës të tipit “A/KL”, nëse vërtetohet njëri nga kushtet e përcaktuara në nenin 77, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar.

12. Të huajt i anulohet leja e punës e tipit “A/KL”, nëse vërtetohet njëra nga situatat e përcaktuara në pikën 1, të nenit 80, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar.

13. I huaji, të cilit i refuzohet ose i anulohet leja e punës e tipit “A/KL”, ka të drejtën e ankimimit, sipas procedurës së përcaktuar në pikën 2, të nenit 81, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar.

14. Leja e punës e tipit “A/KL” përfundon nëse plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 78, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar.

15. I huaji, i cili pajiset për herë të parë me leje pune të tipit “A/KL”, para marrjes së lejes së

punës, detyrohet të paguajë tarifën prej 6 000 (gjashtë mijë) lekësh. I huaji, të cilit i ripërtërihet leja e punës e tipit “A/KL”, para marrjes së kësaj lejeje të ripërtërirë, detyrohet të paguajë tarifën prej 3 000 (tre mijë) lekësh.

16. Drejtoria, që ka në përgjegjësi çështjet e migracionit, në ministrinë e përgjegjëse për çështjet e punësimit, monitoron, në mënyrë periodike, procedurën e ndjekur nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për dhënien e lejes së punës.

17. Vendimi nr. 66, datë 12.2.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe të procedurës për pajisjen, refuzimin dhe anulimin e lejes së punës, si punonjës me kualifikim të lartë, të tipit ‘A/KL’”, shfuqizohet.

18. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



ANEKSI 1

REPUBLIKA E
SHQIPËRISË
MINISTRIA E
FINANCAVE DHE
EKONOMISË



REPUBLIC OF
ALBANIA MINISTRY
OF FINANCE AND
ECONOMY

DREJTUAR:
TO: AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
NATIONAL AGENCY OF EMPLOYMENT AND SKILLS _____

ZYRËS SË PUNËSIMIT
EMPLOYMENT OFFICE _____

**FORMULAR – KËRKESË
APPLICATION**

për lëshimin e lejes së punës një të huaji/for issuance of work permit
to a foreigner

1. TË DHËNAT E PUNËDHËNËSIT/INFORMATION ABOUT THE
EMPLOYER

1. Emri i punëdhënësit _____
Name of the employer
2. Vendi dhe adresa e punëdhënësit _____
Seat and address of the employer
3. Numri i regjistrimit në ISSH |_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|
Registration number in the Cr Health Insurance Institute
4. Kodi fiskal NIPT |_|_|_|_|_|_|_|_|_|_| OIB |_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|
Business activity code
a) Vendimi i gjykatës për njohjen e biznesit ose: _____
Court Decision on Business Acknowledgment or
b) Ekstrakt nga Qendra Kombëtare e Biznesit: _____
Abstract from National Biznes Centre
5. Data e menduar e fillimit dhe e përfundimit të punës |_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_| deri më
|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|



Period for which the work permit is requested from to _____

6. Emërtimi i vendit të punës _____
Name of the job position

7. Kuotat vjetore **PO** **JO**
Yearly quota **YES** **N**

8. Punësimi sezonal **PO** **JO**
Seasonal employment **YES** **NO**

9. Migrimi ditor **PO** **JO**
Daily migration **YES** **NO**

**2. TË DHËNAT E TË HUAJIT/INFORMATION ABOUT THE
FOREIGNER**

1. Mbiemri _____
Surname

2. Emri _____
Given name(s)

3. Emri i babait _____
Name of the parent

4. Datëlindja |__|__|__|__|__|__|__|__|
Date of birth

5. Gjinia **F** **M** |__|__|__|__|__|__|__|__|
Sex **M** **F** * to be entered if issued

6. Vendi dhe shteti i lindjes _____
Place and country of birth

7. Shtetësia _____
Nationality

8. Adresa e banimit në Shqipëri _____
Residential address in the Republic of Albania

9. Kodi dhe emri i punësimit |__|__|__|__|__|__|__|__|
Code and name of occupation

10. Kualifikimet |__|__|__|__|
Skill qualifications

11. Aktivitet fitimprurës **PO** **JO**
Gainfully employed **YES** **NO**



ANEKSI II

(STEMA E AKPA-së)

**AGJENCIA KOMBËTARE E
PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
ZYRA E PUNËSIMIT**

Nr. _____ prot.

Datë

**LEJE PUNE PËR TË
HUAJ
TIPI: A/KL**

Në zbatim të ligjit nr.108/2013, datë 28.3.2013, “Për të huajt”, të ndryshuar, dhe të vendimit nr., datë _____.____.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit e të procedurës për pajisjen, ripërtëritjen, refuzimin dhe anulimin e lejes së punës, si punonjës me kualifikim të lartë, të tipit “A/KL”, si dhe të tarifës shtetërore për lëshimin e kësaj leje pune”,

Z./znj. _____
Mr./Ms. (emri, mbiemri / Given name(s)
Surname)

FOTOGRAFIA / PHOTO


Lindur më _____
Born on (data, muaji, viti / Day Month
Year)

Në _____
In (vendlindja / Place and country of birth)

Gjendja civile _____
(Civil Status)

Me shtetësi _____
Nationality

Me profesion _____
Skill qualifications





Lloji i dokumentit dhe numri _____|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|

Type of document and number

I huaji pajiset me leje pune të tipit A/TN, pasi përfshihet në kategorinë e përcaktuar në nenin 98, të ligjit nr.108/2013, datë 28.3.2013, “Për të huajt”, të ndryshuar.

Për të ushtruar aktivitetin /
veprimtarinë e tij/saj: Name of
the employer

Statusi i subjektit: _____
(Subject's Legal Status)

Spektori i
aktivitetit: _____
(Sector of
Activity)

Me adresë: _____
Seat and address

Vlefshmëria
e lejes: _____
(Work
Permit
Validity)

Data
e
lëshimit:
_____ (Issua
nce
Date)

Data e
skadimit:
_____ (Expira
tion
Date)

Pagesa
:
_____ (Appli
cation
Fee)

Kjo leje pune është e vlefshme derisa i huaji të vazhdojë të bëjë pjesë në këtë kategori punësimi, bazuar në ligjin nr.108/2013, datë 28.3.2013, “Për të huajt”, të ndryshuar.

Institucioni lëshues: _____ (Issuing Authority)



VENDIM

Nr. 926, datë 25.11.2020

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË
BUXHETIN E VITIT 2020 NDËRMJET
MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE
BUXHETORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në buxhetin e vitit 2020, në programin “Përkujdesja sociale”, në artikullin 606, i shtohet fondi prej 2 000 000 000 (dy miliardë) lekësh.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të përballohet nga pakësimi i fondeve korrente për disa ministri dhe institucione buxhetore, sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të gjitha ministrinë/institucionet buxhetore, sipas tabelës nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi, për zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

Tabela nr. 1

Kodi	Emërtimi i institucionit/programit	Vlera në mijë lek e pakësimit
2	Kuvendi	56,000
01120	Veprimtaria ligjvënëse	56,000
3	Kryeministria	43,000
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	43,000
5	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	57,900
04220	Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	34,400
04860	Këshillimi dhe informacioni bujqësor	23,500
10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	355,000
01140	Menaxhimi i të ardhurave tatimore	255,000
10550	Tregu i punës	100,000
12	Ministria e Kulturës	21,000
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	4,000
08220	Trashëgimia kulturore dhe muzetë	11,000
08230	Arti dhe kultura	6,000
13	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	402,100
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	41,800
07330	Shërbimet e kujdesit dytësor	190,500
07450	Shërbimet e shëndetit publik	141,000
07460	Shërbimi Kombëtar i Urgjencës	28,800
14	Ministria e Drejtësisë	20,000
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	20,000
16	Ministria e Brendshme	224,000
03140	Policia e Shtetit	224,000
17	Ministria e Mbrojtjes	367,000
02120	Forcat e Luftimit	234,000
02150	Mbështetja e luftimit	100,000
10910	Emergjencat Civile	33,000
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	110,000
03520	Veprimtaria informative shtetërore	110,000
26	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	63,000
05320	Programe për mbrojtjen e mjedisit	33,000



04260	Administrimi i pyjeve	30,000
29	Këshilli i Lartë i Gjyqësor	150,000
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	10,000
03310	Buxheti gjyqësor	140,000
41	Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar	34,000
03390	Veprimtaria e SPAK-ut	34,000
50	Instituti i Statistikës	60,000
01320	Veprimtaria statistikore	60,000
76	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave	12,000
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	12,000
87	Institucione të tjera qeveritare	25,000
01140	<i>e-Qeverisja</i>	25,000
TOTALI		2,000,000

2,000,000

VENDIM

Nr. 927, datë 25.11.2020

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË
BUXHETIN E VITIT 2020 NDËRMJET
INSTITUCIONEVE TË SISTEMIT
TË DREJTËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në grupin buxhetor nr. 63 “Institucionet e sistemit të drejtësisë”, në programin “Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar”, shtohet fondi prej 4 000 000 (katër milionë) lekësh, në zërin shpenzime personeli.

2. Në grupin buxhetor nr. 63 “Institucionet e sistemit të drejtësisë”, në programin “Veprimtaria e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, pakësohet fondi prej 4 000 000 (katër milionë) lekësh, në zërin shpenzime personeli.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe administrata e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

UDHËZIM

Nr. 472, datë 19.11.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN
NR. 385, DATË 13.10.2020, “PËR
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE
PROCEDURAVE PËR MARRJEN E
LICENCËS PËR ADMINISTRIMIN
KOLEKTIV TË TË DREJTAVE TË
AUTORIT, RIPËRTERITJEN E SAJ, SI
DHE PËRCAKTIMIN E KRITEREVE
DHE PROCEDURAVE PËR
PEZULLIMIN DHE HEQJEN E
LICENCËS NË ZBATIM TË LIGJIT NR.
35/2016, DATË 31.3.2016, “PËR TË
DREJTAT E AUTORIT DHE TË
DREJTAT E TJERA TË LIDHURA
ME TO”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 35, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 385, datë 13.10.2020, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës në zbatim të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” bëhet ndryshimi, si më poshtë:



1. Në kreun I, germa d, pika 4, shtohen fjalët:

“Në çdo rast shtyrja e këtij afati do të bëhet me urdhër të ministrit të Kulturës dhe është i argumentuar”.

2. Ky ndryshim në udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të ministrisë së Kulturës, si dhe në Fletoren Zyrtare.

3. Ngarkohet Drejtoria për të Drejtën e Autorit për njoftimin e këtij udhëzimi.

MINISTËR I KULTURËS
Elva Margariti

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 192 lekë